



REPUBLIKA E SHQIPËRI
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 53 prot.

Kamëz, më 19.04.2022

V E N D I M

Nr. 46 .Datë 19/04/2022

MBI

“ MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, PËR FAMILJET E EVAKUARA NGA BANESAT E TYRE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019 ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.04.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.43 Datë 13.04.2022 në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 8, datë 7.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”, Aktit Normativ nr.37 datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “ Për disa ndryshime të aktit normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave “ Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha sipasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019 ”, nenit 26, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr.132, datë 22.12.2021 të Këshillit Bashkiak “ Për miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2022-2024 ” , si dhe vendimi nr 29 datë 11.03.2022 “ Për nivelin e pagesës se qirasë sipas vleres së tregut; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Pagesën e plotë të qirasë sipas vlerës në tregun e lirë, për individët/familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Afati i pagesës së qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, fillon nga muaji Prill 2022 *deri ne momentin qe familjet futen në shtëpi,siç përcaktohet në Aktitin Normatin nr.37 datë 24.12.2020.*
3. Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit do të koordinojë punën me Njësitë Administrative/LagjetdheDrejtorinë e Rindërtimit për monitorimin e pagesës së qirasë për familjet përfituese, si edhe njofton strukturat përgjegjëse për ndërprerjen e kësaj



REPUBLIKA E SHQIPËRI
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

pagese, në rast se këto familje sistemohen përfundimisht në një banesë ose gjatë monitorimit konstatohet se nuk përmbushin më kushtet për të përfituar pagesën sipas legjislacionit në fuqi.

4. Efektet financiare, do të përballohen në raportin 80% nga Ministria Financës dhe Ekonomisë dhe 20% nga buxheti Bashkisë Kamëz sipas Prog .06180 Art606, “Subvencionim i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti”.
5. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Financave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese:

Nr	Emër Atësi Mbiemër
1	Luan Mahmut Hysenaj
2	Mesur Kasam Puci
3	Maringen Fadil Sela
4	Artan Ndre Bushkolaj
5	Petrit Ndre Bushkolaj
6	Dava Frrok Bushkolaj
7	Sulejman Hamdi Burreli



REPUBLIKA E SHQIPËRI
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Pas miratimit të këtij vendimi, Bashkia Kamëz do të dërgojë me shpresë përcjellëse Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Vendimin e Këshillit Bashkiak për rialokimin e fondeve.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
HYSEN KOLDASHI

